



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202300563/

Tiranë ____/____/2025

Lënda: Rekomandim mbi plotësimin e sistemit elektronik të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme të ASHK dhe përfundimin e shqyrtimit të aplikimit të një shtetasi

Drejtuar: Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Rruga "Dora D'Istra"
Tiranë

Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës-Tirana Veri

Rruga "Jordan Misja"
Tiranë

Për dijeni: Z. S. R.

.....
Tiranë

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, ka filluar shqyrtimin e ankesës së shtetasit S. R., i cili ankohet për vonesë në shqyrtimin e aplikimit të tij për legalizim dhe mospërfundimin e procedurave përkatëse nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Veri (DVASHK Tirana Veri).

Në shpjegimet e tij ankuesi informon se ka bërë një shtesë në pronën që babai i tij ka blerë në vitin 1930 dhe me qëllim legalizimin e kësaj shtese, ka kryer dy vetëdeklarime (në vitet 2017 dhe 2022, të cilat do të trajtohen me hollësi më poshtë).

Ankuesi gjithashtu informon se punonjësit e DVASHK kanë vajtur dy herë në objektin që ai ka kërkuar të legalizohet (në korrik 2017 dhe 16 mars 2023), por sërish nuk ka një përgjigje nga DVASHK Tirana Veri.

Duke qenë se procedura përkatëse nuk kishte përfunduar brenda afateve ligjore dhe duke mos arritur të zgjidhte vetë këtë çështje (si pranë DVASHK Tirana Veri, ashtu edhe pranë

Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, apo edhe në institucione të tjera), ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit tonë.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit konstatoi se ankesa plotësonte të gjitha kushtet thelbësore të formës dhe përmbajtjes për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, respektivisht nenet 13, 17 shkronja "a" dhe 18 shkronja "b", vendosi të pranonte ankesën dhe të fillonte procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Përmbledhja e fakteve:

Për nevoja të shqyrtimit të kësaj çështjeje dhe me qëllim identifikimin sa më të saktë të problematikës së çështjes objekt të hetimit administrativ, me shkresën nr. K3/S22-2 prot., datë 20.09.2023 i jemi drejtuar DVASHK Tirana Veri, duke i kërkuar të na informonte:

1. Nëse vërtet nga inspektorët e DVASHK-së ishin bërë dy vizita në objektin që kërkohej të legalizohej?
2. Pas përgjigjes me e-mail që i ishte kthyer zj. D. R. (ku thuhej se nuk kishte asnjë aplikim për vetëdeklarim për ndërtim pa leje në emër të saj), dhe pas komunikimit nga ankuesi me DVASHK Tirana Veri (ku ai sqaron që bëhej fjalë për të njëjtën pronë, për të cilën ai kishte dorëzuar kërkesën për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit informal që datë 31.05.2017), a është verifikuar nga DVASHK Tirana Veri ky rast?
3. Procedurat që parashikonte të ndiqte DVASHK Tirana Veri dhe afatet ligjore konkrete, brenda të cilave do kryente veprimet përkatëse, për përfundimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

Në përgjigje të sa më sipër, DVASHK Tirana Veri, me shkresën nr. 9721/1 prot., datë 11.10.2023, informoi se: "...në databazën online të vetëdeklarimeve, databazë e administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, rezulton se ankuesi z. S. R. dhe znj. D.R. nuk kanë aplikim të përfshirë për legalizimin e ndërtimit informal. Në bazë të shqyrtimit të shkresës tuaj, u konstatua se më datë 02.09.2022 znj. D.R. ka aplikuar në e-albania shërbimin "Vërtetim i aplikimit për legalizim ndërtimi informal", shërbim i cili ofrohet për subjektet, ndërtimet informale të të cilëve janë përfshirë në databazën online të vetëdeklarimeve, ndërkohë që shërbimi i cili duhej të aplikohet është "Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje". Për sa më lart, shtetasit z. S. R. dhe znj. D.R. duhet të aplikojnë nëpërmjet portalit e-albania shërbimin "kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje", konform VKM-së nr. 1178, dt. 24.12.2020, për të bërë të mundur përfshirjen e ndërtimit informal në databazën online të vetëdeklarimeve".

Ndërkohë në lidhje me pyetjen tonë, për tu shprehur mbi pretendimin e ankuesit, që nga ana e punonjësve të DVASHK janë bërë dy vizita në objekt, nuk u kthye fare përgjigje.

Pas nisjes së hetimit administrativ nga institucioni ynë, ankuesi në datë 27.02.2024, ka sjellë dokumentacion shtesë, e më konkretisht:

- dy shkresa të DVASHK Tirana Veri, nr. 9540/2 prot., datë 15.12.2023 dhe nr. 9540/4 prot., datë 17.01.2024, në të cilat thuhet se: "...aplikimi nuk rezulton i regjistruar në databazën online të vetëdeklarimeve të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, për tu bërë pjesë e procesit të legalizimit...". Gjithashtu në këto shkresa DVASHK Tirana Veri i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, citojmë: "përfshirjen në databazën online të vetëdeklarimeve të aplikimit nr. 11622, datë 02.09.2022 "Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje", të kryer nga znj. D.R. "

- dy shkresa të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, (përkatësisht nr. 9804/1 prot., datë 26.05.2022 dhe nr. 9804/6 prot., datë 20.12.2022, drejtuar DVASHK Tr. Veri dhe për dijeni ankuesit S. R.), ku i kërkohet DVASHK Tr. Veri, të marrë masa për trajtimin e kërkesë së ankuesit S. R., si dhe ti jepte këtij të fundit orientimet përkatëse për veprimet që duhet të kryente.

Pavarësisht shkresave të mësipërme, nga ana e ankuesit këmbëngulej se aplikimi i dytë (bërë nga bashkëshortja e tij zj. D. R.), figuronte i hedhur në sistemin e brendshëm të ASHK-së, ndaj për të vërtetuar këtë informacion, bazuar në nenin 19, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, sipas të cilit: “Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë:

a) të kryejë hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve ose dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton.

b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin;

c) të marrë në pyetje çdo person, që sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim, dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa imunitet. ...”

në datë 16.07.2025, nga nëpunësit e institucionit tonë, u krye një inspektim në një prej kompjuterëve të DVASHK Tirana Veri¹ dhe nga verifikimi i sistemit të brendshëm online të ASHK-së, rezultoi se:

- Nuk kishte në sistem aplikim në emër të shtetasit S. R.
- Ishte i regjistruar në sistemin e brendshëm të ASHK-së, aplikimi i shtetases D. R.

Analiza ligjore e rastit

1. *Problematika e mosshfaqjes në sistemin elektronik të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme të ASHK-së, të aplikimeve për legalizim bërë nga shtetas të ndryshëm.*

Nga hetimi administrativ për këtë rast rezultoi se:

- Me shkresën e DVASHK Tirana Veri, nr. 12192/1 prot., datë 03.12.2019, drejtuar z. S. R., konfirmohet që ankuesi ka bërë një kërkesë për legalizim, citojmë: “Pas verifikimit pranë arkivë protokollit që administrohet pranë drejtorisë tonë rezulton se shtetasi S. R. ka dorëzuar kërkesën për përfshirje në procedurat e legalizimit në ndërtimin informal të ndodhur në Njësinë Administrative nr. 9. Objekti figuron me këto të dhëna: Nr. kërkesë 2923; Data 31.05.2017; Objekti: Ndërtim pa leje; Adresa e truallit të ndërtimit: Nj. 9”.

- Në ankesën e tij ankuesi informon se pas bërjes së kërkesës së mësipërme për legalizim, ai i dhuroi me akt noterial pronën bashkëshortes (zj. D.R.) dhe vajzës së tij, ndaj znj. D. R. në datë 02.09.2022 ka bërë një aplikim të dytë për legalizim, po për të njëjtën pronë (veprim ky që provohet nga dokumenti “Kërkesë/aplikim për legalizimin e ndërtimit pa leje, nr. 11622, datë 02.09.2022”, i administruar në dosje), si dhe ka kryer edhe pagesën përkatëse.²

- Pavarësisht se nga ana e DVASHK Tirana Veri, me dy shkresa të ndryshme,³ i kërkohej

¹ Veprim për të cilin u mbajt edhe proces-verbali përkatës

² Sipas shpjegimeve të ankuesit, një aplikim i tillë është bërë në vijim të shkresës së DVASHK-së datë 08.07.2022, ku i kërkohej aplikuesit të bënte aplikim online.

³ Nr. 9540/2 prot., datë 15.12.2023 dhe nr. 9540/4 prot., datë 17.01.2024, të cituara më sipër

Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, hedhja në sistem e aplikimit të datës 02.09.2022 bërë nga shtetasja D. R., nuk ka një përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së mbi kryerjen ose jo të këtij veprimi.

Duke qenë se nuk është hera e parë që institucioni ynë ndeshet me një situatë të tillë, do donim të ndaleshim më gjatë në analizën e kësaj problematike.

Më konkretisht ne jemi vënë në dijeni edhe më parë, të situatave të ngjashme me sa më sipër, p.sh. të rastit kur ankuesi ka aplikuar online, ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës pranë DVASHK Tirana Veri që provon kryerjen e aplikimit online, por nga ana e DVASHK Tirana Veri nuk është vepruar, me arsyetimin se aplikimi nuk shfaqet në sistemin online dhe se administrimi i këtij sistemi (përfshirë hedhjen e aplikimit fillestar në sistemin online) kryhet vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së.

Në Rekomandimin përkatës për atë rast,⁴ jemi shprehur se: *“Në lidhje me kërkesën tuaj për mungesën e vetëdeklarimit online të ankueses...- Edhe sikur të marrim rastin hipotetik që institucioni juaj do e kishte konstatuar më vonë një gjë të tillë (pra mungesën e aplikimit online), sërish ju kujtojmë se referenca ligjore e cituar në shkresën tuaj (VKM nr. 1178, datë 24.12.2020), në vlerësimin e institucionit tonë është e gabuar. Kjo pasi as në ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, as në VKM nr. 1178, datë 24.12.2020 dhe as në ndonjë akt tjetër normativ (ligjor, apo nënligjor), nuk parashikohet që shtetasit të cilët kanë bërë aplikimet e tyre përpara hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je, duhet të ribëjnë aplikimet (kujtojmë që aplikimi i kësaj shtetaseje është bërë në datë 26.07.2019).*

Nëse bëhet fjalë për hedhjen e pasaktë të të dhënave në sistemin tuaj të të dhënave, gabimet gjatë hedhjes së këtyre të dhënave, apo mosmbajtja si duhet e tyre nga institucionet shtetërore, jo vetëm vjen ndesh me qëllimin e krijimit të këtyre sistemeve (një ndër të cilët është lehtësimi i punës), por mbi të gjitha nuk mund dhe nuk duhet t’i penalizojë shtetasit, nga liritë dhe të drejtat e garantuara nga Kushtetuta dhe ligji, siç është edhe e drejta e pronës në rastin konkret. Përkundrazi bazuar në detyrimet e Kodit të Procedurave Administrative (veçanërisht nenet, 4, 5, 10, 13, 14, 15, 16, 18, 21a, etj.), është detyrë e institucioneve shtetërore, të kujdesen për ndreqjen e këtyre gabimeve, që për më tepër mund të jenë shkaktuar nga vetë nëpunësit e tyre.

Po bazuar në parimet e mësipërme, në momentin që institucioni juaj është vënë në dijeni të kësaj mospërputhjeje (pra faktit që qytetari ka bërë aplikimin, por në bazën e të dhënave në sistemin digjital të vetëdeklarimeve informale (online), në emër të këtij subjekti nuk figuron vetëdeklarim, do duhej që t’iu bënte të thelloheshit më tepër, jo vetëm për të kuptuar arsyet e ndodhjes së kësaj mospërputhjeje, por mbi të gjitha për të dhënë ju vetë propozime për zgjidhjen e këtij problemi, i cili në pamje të parë, duket sikur është krijuar po nga nëpunës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (pasi qytetarët nuk kanë akses në krijimin e këtij sistemi, apo ca më tepër në ndreqjen e gabimeve që mund të konstatohen)”.

Pra në lidhje me të tilla situata, rekomandojmë që rastet të hetohen administrativisht, për të kuptuar se cilat janë arsyet e krijimit të problemit dhe mbi të gjitha, marrjen e masave për mospërsëritjen e të tilla problematikave në të ardhmen.

⁴ Rekomandimi “Për përfundimin e një procedure legalizimi”, dërguar DVASHK Tirana Veri dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, me shkresën nr. K3/I39-6 prot., datë 26.12.2023, por që ka mbetur i pazbatuar.

Gjithashtu nga sa më sipër konstatojmë një moskoordinim ndërmjet institucionit epror (Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së) dhe atyre të varësisë (DVASHK-ve), në lidhje me marrjen e masave për hedhjen në sistem të aplikimeve.

Kjo jo vetëm në rastin e ankuesit S. R. (ku rezulton që DVASHK Tirana Veri, i ka kërkuar shkresërisht Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së hedhjen në sistem të aplikimit), por në rastin e shtetas I. H., jo vetëm që një veprim i tillë nuk është ndërmarrë nga DVASHK Tirana Veri (pra nuk i ka bërë me dije Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së mosshfaqjen në sistem të këtij aplikimi), por përkundrazi nuk është njoftuar as aplikuesja për një problematikë të tillë (gjë që u zbulua vetëm gjatë hetimit tonë administrativ, pasi aplikueses nuk i kthehej asnjë përgjigje, pavarësisht kërkesave të saj të shumta).

Ne besojmë se sa më sipër janë raste të rralla, por nisur edhe nga raste të tjera të konstatuara gjatë punës tonë, për të mos u përsëritur më situata të tilla në të ardhmen, do rekomandonim që Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, të udhëzojë zyrtarisht të gjitha Drejtoritë Vendore të Agjencive Shtetërore të Kadastrës, që në rastet kur vijnë në dijeni të aplikimeve për legalizim, të bëra në përputhje me legjislacionit në fuqi, por që nuk shfaqen në sistemin elektronik të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme të ASHK-së, të njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së për zgjidhjen e problemit (pra për hedhjen në sistemin online të këtyre aplikimeve).

Nga ana tjetër edhe Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, me marrjen dijeni nga DVASHK-të për këtë problematikë (pra të mosshfaqjes së kërkesës/aplikimit për legalizim, në sistemin online të ASHK), të hedhë menjëherë në sistemin elektronik të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme të ASHK-së, aplikimin përkatës.

Shtojmë se për institucionin tonë, nuk është në harmoni me nenin 10, të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, zgjidhja teknike e aplikuar në sistemin elektronik të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme të ASHK-së, ku aplikimet fillestare që shtetasit bënin nëpërmjet platformës e-albania për legalizimet, nuk ju shfaqeshin DVASHK-ve, në se nuk kryhej veprim në sistemin online, nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së.

Sa më sipër bazohet ndër të tjera edhe në parimet e Kodit të Procedurave Administrative (nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, 16, 18), si pjesë e detyrave funksionale të nëpunësve të administratës, në kuadër të ndihmës që duhet ti jepet shtetasve pjesëmarrës në një procedurë administrative dhe jo të shmanget përgjegjësia, ku institucionet ja përcjellë njëri-tjetrit detyrimin.

2. Problematika e mospërfundimit të shqyrtimit të aplikimit, brenda një afati të arsyeshëm

Në rastin e ankuesit S.R., kemi konstatuar edhe shkeljen e afateve të trajtimit të çështjes. Arrijmë në këtë konkluzion pas sa vijon: Ndodhur në kushtet kur ligji i posaçëm nuk parashikon afate për përfundimin e këtij procesi administrativ individual, do t’i referohemi dispozitave të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, i cili:

- në nenin 21 parashikon se: “Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore. 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes

konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”,

- në nenin 91 parashikon se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre. Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, procedura administrative përfundon brenda 3 muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme. Mosrespektimi i afateve kohore, të parashikuara në këtë nen, duhet të justifikohet nga organi përgjegjës para organit epror ose nga nëpunësi përgjegjës përpara eprorit të tij, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit ose nga përfundimi i gjendjes së jashtëzakonshme”.

- në nenin 92, parashikon se: “1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi. 2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar. 3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit”, ndërkohë që nga dokumentacioni përkatës i depozituar bashkëngjitur kërkesës së ankuesit, nuk rezulton që të jetë bërë zgjatje e afateve të sipërcituara.

Pra, asnjë organ administrativ/institucion shtetëror nuk mund të fillojë një procedurë administrative dhe ta zvarrisë pafundësisht, por duhet ta përfundojë atë brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

Afatet ligjore fillojnë në ditën e paraqitjes së kërkesës apo ankesës në një organ të administratës publike dhe përfundojnë në datën e shpalljes së vendimit përfundimtar administrativ. Qëllimi i vendosjes së afateve ligjore dhe respektimi i tyre është përfundimi sa më shpejt i procedurës administrative dhe brenda një kohe të arsyeshme, në respektim të procesit të rregullt ligjor.

Respektimi i afateve gjatë procesit administrativ përbën bazën e sigurt të çdo rendi juridik ligjor e demokratik pasi:

- procesi administrativ përbën hallkën e parë dhe më të prekshme të procesit ligjor, përmes të cilit qytetari në përpjekje për të fituar apo mbrojtur të drejtat dhe liritë e tij përballet me administratën shtetërore dhe vendore.
- procesi administrativ tregon qartë cilësinë e aksesit në drejtësi, pasi gjatë këtij procesi çdo shtetas kupton dhe percepton më qartë mënyrën se si jepet drejtësia. Mungesa e afateve të arsyeshme në përfundimin e procesit administrativ e bën të paplotë këtë angazhim, duke cenuar drejtpërdrejtë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.
- procesi administrativ duke cenuar procesin e rregullt ligjor, ka mohuar garancinë për çdo shtetas ndaj veprimeve të paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe detyrim për këto të fundit që të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, gjatë veprimtarisë së tyre administrative.

-detyrimi për një proces të rregullt ligjor buron edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6 i saj, i cili kërkon detyrimisht aplikim rigoroz nga instrumentet e brendshëm të një shteti.

Në respekt të këtyre parashikimeve, e drejta për një proces të rregullt ligjor është ngritur në nivel Kushtetues, ku konkretisht neni 42, paragrafi 1 parashikon se: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe ligj, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”*.

Referuar rastit të paraqitur nga ankuesi, shtojmë se detyrimi për të shqyrtuar aplikimet dhe kthyer një përgjigje, ka qenë i DVASHK Tirana Veri, ndaj organi administrativ, që duhet të zbatonte këto detyrime ligjore, ndër të tjera edhe në kuadër të sigurimit të një procesi të rregullt ligjor, nga informacioni i grumbulluar deri më sot, rezulton të mos i ketë përmbushur detyrimet e tij. Gjithashtu hetimi ynë administrativ ka treguar se *jo vetëm konstatohet tejkalimi i afateve të arsyeshme, por vlerësohet i drejtë shqetësimi i ngritur nga ankuesi, për shkeljen e afateve ligjore, në rastin e trajtimit të dy aplikimeve të tij.*

Problematika në lidhje me këtë rast, për sa kohë që nuk ka një vendim administrativ lidhur me trajtimin e aplikimeve të tij, jo vetëm që prek të drejtat e shtetasve për t’iu trajtuar çështja brenda afateve të parashikuara nga aktet normative në fuqi, në mënyrë të ligjshme, transparente, të paanshme, të drejtë, por prek edhe të drejtën e tij për t’u informuar për veprimtarinë e organeve shtetërore.

Këto janë të drejta të parashikuara jo vetëm nga Kodi i Procedurave Administrative (nenet 4, 5, 6, 10, 13, 15, 18/2, etj.), por së pari nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në:

- Nenin 23, pika 2, parashikon se: *“2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, ...”*.
- Neni 42, pika 1, parashikon se: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”*.
- Neni 15, pika 2, parashikon se: *“organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*.

Në analizë të parashikimeve Kushtetuese rezulton se ankuesi për shkaqe të pavarura nga ai, nuk arrin të marrë një vendim përfundimtar në një procedurë administrative, në një kohë që ka respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës, e për rrjedhojë ai kufizohet në gëzimin e plotë të pronës së tij, si dhe të drejtave që i garanton legjislacioni në fuqi. *Institucioni ynë vlerëson se vonesa në trajtimin e kësaj praktike, kufizon liritë dhe të drejtat e tij* (apo edhe të familjarëve të tij, pasi ai tashmë e ka dhuruar pronën).

Veprimet (apo mosveprimet) e mësipërme, siç përmendëm edhe më sipër, e vendosin institucionin tuaj përpara shkeljes së procesit të rregullt ligjor, në zhvillimin e këtij procesi administrativ, ndaj vlerësojmë se institucioni juaj duhet të përmbushë detyrimet ligjore në lidhje me procedurat, duke shmangur vonesat e panevojshme, që mund të jenë shkaktuar nga: inercia, neglizhenca apo zvarritja e qëllimshme e procesit, pasi Institucioni i Avokatit të Popullit ka mandat të vlerësojë jo vetëm veprimet e paligjshme të administratës publike por edhe veprimet e parregullta të saj.

Gjithashtu si ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 111/2018 “Për kadastrën”, Kodi i Procedurave

Administrative, apo edhe akte të tjera normative, parashikojnë detyrime për ASHK-të, që të jenë transparente në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, pasi krahas mundësisë së drejtës së informimit, ato duhet të ndërmarrin veprime konkrete dhe të zbatojnë programe efikase informimi (si për aplikuesit, ashtu edhe për publikun e gjerë), lidhur me efektet e ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të këtij institucioni.

Informimi dhe ndihma që i duhet dhënë shtetasve, janë jo vetëm detyrime ligjore,⁵ por në vlerësimin e institucionit tonë edhe elementë shumë të rëndësishëm, për garantimin e përfundimit me sukses të proceseve kalimtare të pronësisë. *Zvarritja e procesit nga ana e institucionit tuaj nuk gjen asnjë justifikim ligjor apo të arsyeshëm dhe mbi të gjitha cenon sigurinë juridike në një shtet demokratik.* Kjo për arsye se parimi i sigurisë juridike presupozon besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe jo vetëm pandryshueshmërinë e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara, por edhe garantimin e ligjshmërisë së veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, sigurinë juridike se qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Institucioni ynë përpigjet të mirëkuptojë volumin e madh të rasteve që mund të kenë në trajtim DVASHK të ndryshme, por nga ana tjetër duke pasur parasysh rëndësinë e zgjidhjes së problemeve të pronësisë, si në raport me garantimin e të drejtës së pronësisë së shtetasve, ashtu edhe për zhvillimin ekonomik të vendit, në rast se vonesat në trajtimin e praktikave, jo vetëm përtej afateve ligjore, por edhe përtej çdo *afati të arsyeshëm*, zgjidhja nuk është të lihen pa u trajtuar kërkesat e shtetasve.

Nuk po ndalemi në analizën me hollësi të konceptit të *afatit të arsyeshëm*, pasi e kemi trajtuar në Rekomandime të mëparshme drejtuar DVASHK-së tuaj dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, por theksojmë se ngarkesa e institucionit tuaj, nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë si arsye për zgjatjen e mosshqyrtimit të rasteve. Pra jo vetëm që kjo vonesë nuk mund të konsiderohet si e arsyeshme, por siç kemi përmendur në Rekomandimet e mëparshme, *mosshqyrtimi administrativ i aplikimeve të shtetasve (pavarësisht llojit të shërbimit kadastrale) brenda afateve ligjor dhe/ose atij të arsyeshëm, në varësi edhe të rrethanave të tjera të çështjes, mund të përbëjnë shkak për nisjen e një procesi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustificuar e procedurës administrative.*

Së fundi por jo për nga rëndësia, theksojmë se shkelja e të drejtave të mësipërme, sjell në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga: *humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike*, e deri tek *rreziku i përballjes së organeve të administratës shtetërore me padi civile për dëm jashtëkontraktor*, që mund tu jetë shkaktuar shtetasve, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura.

Për gjithë sa më sipër, me qëllim për të mos vonuar edhe më tej këtë procedurë, bazuar në:

- a. Nenin 60, të Kushtetutës, sipas të cilit: “1. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. ...”,

⁵ Kodi i Procedurave Administrative, neni 10 - *Parimi i dhënies së ndihmës aktive*, parashikon se: “1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre. 2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik. 3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit”).

- b. Nenin 2, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, sipas të cilit: *“Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj....”*,
- c. Nenin 63, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: *“3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.....”*,
- d. Nenit 21, gërma “b”, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, sipas të cilit: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:... b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË

1. Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së:
 - 1.1. Të marrë masa organizative, duke udhëzuar të gjitha Drejtoritë Vendore të Agjencive Shtetërore të Kadastrës, që në rastet kur vijnë në dijeni të aplikimeve për legalizim, të cilat nuk shfaqen në sistemin elektronik të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme të ASHK-së, të njoftojnë zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së për zgjidhjen e problemit (pra për hedhjen në sistemin online të këtyre aplikimeve).
Me marrjen dijeni nga DVASHK-të për këtë problematike (pra të mosshfaqjes së kërkesës/aplikimit për legalizim, në sistemin online të ASHK), Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, të hedhë menjëherë në sistemin elektronik të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme, aplikimin përkatës.
2. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të përfundojë pa vonesa të mëtejshme, shqyrtimin e aplikimit për legalizimin e ndërtimit pa leje të familjes R..

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” , të ndryshuar, *“Detyrimi i organeve të administratës për t’iu përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit”*, sipas të cilit: *“Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigjja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ. Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij”*, lutemi që Drejtoria e Përgjithshme e ASHK dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të na vënë në dijeni mbi zbatimin e këtij Rekomandimi, brenda afatit ligjor të sipërcituar.

Duke ju falënderuar paraprakisht,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI